



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“MOBILIERI DHE TAPICERI”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**C1- III-22**

Tiranë 2022

---

<sup>1</sup>Korniza Shqiptare e Kualifikimit

<sup>2</sup> Korniza evropiane e kualifikimeve

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site: [www.akafp.gov.al](http://www.akafp.gov.al)

Tel/fax.+355 42237087

Emërtimi i kualifikimit	Mobilieri dhe tapiceri			Kodi C1- III -22
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin mësimor “Mobilieri dhe tapiceri”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është “zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me mobilierinë e tapicerinë. Zhvillimi te individi i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në profilin mësimor “Mobilieri dhe tapiceri” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</li> <li>– janë në kushte shëndetësore që e lejojnë përballimin e kërkesave të këtij niveli të kualifikimit profesional.</li> </ul> <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucioni përgjegjës përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Mobilieri dhe tapiceri”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit, të punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional, të punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme që kanë veprimtari për prodhime mobilerie/tapicerie, në repartet e makinerive të përpunimit të drurit, në montimin e mobilieve, lyerjen dhe lustrim, në repartet të tapicerisë, në mirëmbajtjen e mobilieve, në njësi të shitjes së materialeve të mobilierisë apo të shitjeve të mobilieve etj.</p> <p>Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin “Mobilieri dhe tapiceri” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, lejon vazhdimin e shkollimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK (teknik/menaxherial), për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	C-II-01-11, C- II-01-18			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

**Rezultatet e të nxënit në:**

## **NJOHURI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Mobilieri dhe tapiceri” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme::

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të shpjegojë mënyrën e evidentimit të kërkesave të klientit;
- Të shpjegojë rëndësinë e analizimit të kërkesës së klientit për plotësim e saj;
- Të shpjegojë mënyrën e skicimit paraprak të objektit prej druri, sipas kërkesës së klientit.
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të lëndës së parë dhe ndihmëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe sigurimit të mjeteve e makinave sipas të proceseve të nevojshme të punës për realizimin e objektit;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të makinave dhe pajisjeve;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të burimeve njerëzore dhe financiare;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të afatit kohor të realizimit të objektit;
- Të shpjegojë mënyrat e sigurimit të bazës materiale të nevojshme.

### **Përgatitja e vendit të punës**

- Të listojë llojet e matjeve dhe mënyra e kryerjes së tyre;
- Të shpjegojë rëndësia e skicimit të saktë sipas matjeve dhe modelit;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me klientin për informim dhe përfshirjen e kërkesave të tij në skicën përfundimtare të objektit të kërkuar;
- Të interpretojë vizatimet përmbledhëse të objektit përkatës prej druri;
- Të interpretojë vizatimet e detaleve sipas radhës, me numrin e nevojshëm të pamjeve, gjatë zbrërthimit të objektit përkatës prej druri;
- Të listojë llojet e materialeve, veçoritë dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë llojet dhe proceset e punës që kryhen;
- Të listojë llojet e veglave dhe pajisjeve të mekanizuara të dorës sipas proceseve që kryen;
- Të listojë llojet e makinerive sipas proceseve që kryejnë;
- Të shpjegojë mënyrën e përcaktimit të radhës së punës sipas procesit teknologjik;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të vendit të punës, në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë mënyrën e sistemit të materialeve në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit me mjetet përkatëse të transportit;
- Të listojë llojet e instrumenteve të nevojshëm sipas makinave përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të cilësisë së instrumenteve;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së instrumentit në makinë;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të makinerive për evidentim të defekteve;
- Të shpjegojë rëndësinë e regjistrimit të makinerive sipas proceseve teknologjike;

- Të shpjegojë rëndësinë e sistemimit të materialeve të punuara;
- Të shpjegojë rëndësinë e pastrimit të vendit të punës sipas standardeve.

### **Mjetet, veglat dhe pajisjet e punës**

- Të listojë mjetet e punës për montimin mobilieve në linja zinxhir;
- Të përshkruajë mjetet e punës në linjat e lustrimit me sprucim dhe me zhytje;
- Të përshkruajë mjetet e punës në linjat e përpunimit të shtresës të llakut dhe tharjes;
- Të listojë mjetet e punës gjatë proceseve të imitimit të drurit;
- Të dallojë mjetet për kontroll të punimeve të objekteve të ndryshme prej druri.
- Të klasifikojë instrumentet e sharrimit;
- Të klasifikojë instrumentet e drejtimit;
- Të klasifikojë instrumentet e frezimit;
- Të klasifikojë instrumentet e tornimit;
- Të klasifikojë instrumentet e shpimit;
- Të klasifikojë instrumentet e zumparimit.
- Të dallojë instrumentet e frezimit në vartësi të llojeve të punimit;
- Të shpjegojë veçoritë e ndërtimit dhe funksionimit të makinave të mprehjes;
- Të rendisë mjetet e punës që përdoren për tapicerinë;
- Të përshkruajë mjetet e punës, për procesin e përgatitjes të materialeve, për mbushje;
- Të listojë mjetet e punës për sektorin e krijimit të bazës të tapicerisë me susta dhe sfungjer;
- Të përshkruajë mjetet e punës për procesin e qepjes së dyshekut, të materialit mbushës e të veshjes;
- Të listojë mjetet e punës për procesin e qepjeve dhe vendosjen e elementeve dekorativë;
- Të dallojë mjetet për kontroll të punimeve të objekteve të ndryshme prej druri.

### **Makineritë**

- Të shpjegojë funksionin e makinave të ndryshme që përdoren për prodhimin e objekteve prej druri;
- Të shpjegojë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes së makinave të sharrimit, sharrë shirit, sharrë rrethore disk, etj.;
- Të shpjegojë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes së makinave të shkurtimit me saktësi, si makinat sharrë disk;
- Të shpjegojë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes së makinave plan drejtuese;
- Të shpjegojë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes së makinave grosecë;
- Të shpjegojë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes të makinave frezë, kopjuese me zinxhirë etj.;
- Të shpjegojë veçoritë e ndërtimit dhe funksionimin të makinave të thithëzimit;
- Të klasifikojë makinat e tornimit;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e makinës torno universale;
- Të shpjegojë veçoritë e ndërtimit dhe punimit të tornos kopjuese;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të shpimit me shumë punto;
- Të shpjegojë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes së makinave të zumparimit;
- Të dallojë veçoritë e ndërtimit të makinave të formatizimit;
- Të dallojë makinat e kalibrimit;
- Të dallojë llojet e pajisjeve për presim;

- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e presave mekanike, hidraulike, pneumatike;
- Të klasifikojë makinat për veshjen e brinjëve të pllakave e detaleve;
- Të dallojë makinat e imitimit të drurit kalibrimit;
- Të dallojë makineritë për përkulje të drurit;
- Të dallojë makineritë për montimin e objekteve të drurit;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjes për lustrim me sprucim dhe me zhytje;
- Të rendisë makinat dhe pajisjet që përdoren për tapicerinë e avancuar.

### **Punime me vegla dore dhe mjete të mekanizuara të dorës**

- Të listojë instrumentet matës sipas përdorimit të tyre
- Të përshkruajë llojet shënjimeve dhe mjetet e materialet përkatëse të matjeve të kryera;
- Të shpjegojë llojet dhe mënyrën e punimit me sharrat e dorës, sharrat e mekanizuara të dorës;
- Të përshkruajë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit me zdrukthet e dorës, zdrukthet e mekanizuara të dorës;
- Të shpjegojë veglat dhe instrumentet shpuese, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë funksionimin dhe përdorimin e veglave dhe instrumenteve profiluese;
- Të rendisë proceset që kryen me veglat e axhustimit dhe relevimit të dorës dhe mjetet e mekanizuara sipas funksionimit të tyre;
- Të përshkruajë përgatitjen për punë të mjeteve të zumparimit me dorë dhe mjetet e mekanizuara sipas funksionimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e pastrimit të materialeve të punuara me mjete, pajisje dhe solucione përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e pastrimit të veglave të dorës ose të mekanizuara të dorës pas procesit të punës;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimit me mjetet përkatëse.

### **Punime në makineri**

- Të rendisë punimet që kryen me makinat e sharrimit;
- Të listojë proceset e punës që kryen me makinat e shkurtimit;
- Të shpjegojë mënyrën e punimit me makinat e drejtimit;
- Të shpjegojë përgatitjen dhe mënyrën e punimit në makinën grosecë;
- Të shpjegojë mënyrën e punimit me makinat frezë, frezë kopjuese, me zinxhirë, etj.;
- Të rendisë punimet që kryhen me makinat e frezimit të drurit;
- Të përshkruajë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat e thithëzimit;
- Të listojë proceset e punës që kryhen në makinat e thithëzimit;
- Të përshkruajë bërjen e folesë në makina trapano dhe frezë me zinxhirë;
- Të rendisë punimet që kryhen në makinat torno universale dhe kopjuese;
- Të shpjegojë përgatitjen dhe mënyrën e punimit në makinën torno;
- Të rendisë llojet e punimeve që kryhen në makinat e shpimit të drurit;
- Të rendisë veprimet e përgatitjes të makinës për punë dhe procesit të mprehjes;
- Të rendisë proceset e punës që kryhen në makinat trapano, mënyrën e punimit në makinat e shpimit me shumë punto;
- Të rendisë proceset e punës që kryhen në makinat e zumparimit.
- Të shpjegojë proceset e punës dhe mënyrën e punimit në makinat e formatizimit.

- Të përshkruajë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat e kalibrimit;
- Të shpjegojë veçoritë e llojeve të ndryshme të pajisjeve për presim;
- Të shpjegojë proceset e punës që kryhen me presat mekanike, hidraulike, pneumatike;
- Të rendisë veprimet e përgatitjes të makinës, për veshjen e brinjëve të pllakave e detaleve për punë dhe llojet e punimeve që kryhen;
- Të rendisë proceset e punës që kryhen në makineritë për përkulje të drurit me apo pa trajtim paraprak të tij;
- Të shpjegojë proceset e punës me makinat dhe pajisjet që përdoren për tapicerinë e avancuar.

### **Punime finisimi**

- Të përshkruajë llojet e stukove, recetat dhe mënyrat e stukimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e zumparimit përfundimtar;
- Të shpjegojë mjetet dhe materialet e lyerjes me lëndë ngjitëse, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
- Të listojë mënyrat e lyerjes me lëndë ngjitëse sipas normativave;
- Të shpjegojë mjetet dhe materialet e lustrimit, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e lustrimit të sipërfaqeve të detaleve sipas kërkesës;
- Të dallojë mënyrat e tharjes së shtresave të lustrës;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të regjimit të procesit të tharjes së shtresës së lustrës;
- Të listojë llojet e aksesorëve, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e vendosjes së aksesorëve të nevojshëm, sipas modeli.

### **Punime lyerje dhe lustrimi me makina**

- Të listojë mënyrat e imitimit të drurit;
- Të dallojë procesin e imitimit me dorë nga ajo me makinë;
- Të shpjegojë përgatitjen për punë dhe përdorimin e makinës gjatë procesit të patinimit;
- Të përshkruajë procesin e patinimit me makina;
- Të shpjegojë procesin lyerjes dhe lustrimit, si dhe rëndësinë e tij;
- Të përshkruajë procesin lyerjes dhe lustrimit me pajisje sprucimi dhe zhytje;
- Të përshkruajë procesin lyerjes dhe lustrimit me derdhje në makinën përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e aplikimeve të thjeshta të lëndëve kimike në dru.

### **Punime montimi**

- Të shpjegojë mënyrat dhe mjetet e transportit të sigurt të materialit në sektorin e montimit;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të saktësisë së punimeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e krahasimit të matjeve të kryera me kartën teknologjike;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes dhe sistemimit të elementeve të punuara sipas përmasave dhe cilësisë;
- Të rendisë radhën e veprimeve për montim të objekteve prej druri apo mobilieve të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrën e montimit artizanal të çdo lloj objekti prej druri si, dyer, dritare, mobilieje të ndryshme etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e montimit paraprak të objektit;
- Të shpjegojë mënyrën e eliminimit të gabimeve të montimit;
- Të përshkruajë montimin e mobilieve në linja zinxhir;
- Të shpjegojë veçoritë e ndërtimit dhe përdorimit të mobilieve të përkulura;

- Të rendisë veprimet për përkuljen e rimesos dhe kompensatës me shtresa ;

### **Punime tapicerie**

- Të shpjegojë skemat e skeleteve prej druri të objekteve të ndryshme të tapicerisë;
- Të shpjegojë veçoritë e ndërtimit të skeleteve që vishen me tapiceri;
- Të listojë tipet e skeleteve mbi bazën e materialeve të ndërtimit të tyre;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe montimin e skeleteve të objekteve të tapicuara, me bazë druri;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe montimin e skeleteve metalikë, plastikë etj.;
- Të shpjegojë skemat e tapicerisë së mobilieve, me bazë sfungjeri dhe materiale të tjera;
- Të shpjegojë procesin e prerjes dhe qepjes të materialit të veshjes për mobiliet e tapicerisë;
- Të shpjegojë procesin e përgatitjes të materialeve për mbushje, për objekte të ndryshme tapicerie;
- Të shpjegojë procesin e krijimit të bazës të tapicerisë me susta dhe sfungjer, për objekte të ndryshme tapicerie;
- Të përshkruajë procesin e qepjes së dyshekut, të materialit mbushës e të veshjes për objekte të ndryshme tapicerie;
- Të përshkruajë procesin e qepjeve dhe vendosjen e elementeve dekorativë për objekte të ndryshme tapicerie.

### **Mirëmbajtje të pajisjeve dhe makinerive;**

- Të shpjegojë operacionet e mirëmbajtjes të instrumenteve të makinave të ndryshme që përdoren në prodhimin e objekteve prej druri;
- Të shpjegojë mënyrën e mprehjes së instrumenteve me makinën përkatëse;
- Të listojë riparimet kryesore të nevojshme që duhet t'i bëhen makinave të ndryshme që përdoren në prodhimin e objekteve prej druri, mobilieve dhe objekteve të tapicerisë;

### **Riparime dhe restaurime për objekte druri**

- Të përshkruajë hapat e mirëmbajtjes dhe restaurimit të objekteve të përdorura prej druri dhe me material gjysmë të gatshme;
- Të shpjegojë mënyrën e pastrimit të objekteve të përdorura, mjetet dhe materialet përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e dezinfektimit me antiseptikë të objekteve të përdorura prej druri;
- Të listojë llojet e defekteve të mundshme të elementeve dhe mënyrat e identifikimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e riparimit të defekteve tek elementet e dëmtuar;
- Të shpjegojë procesin e cenoblimit dhe rëndësinë e tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e pastrimit mbas cenoblimit të elementi i dëmtuar;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e rimesimit, patinimit të pjesshëm të elementët dhe pllakat e dëmtuara;
- Të shpjegojë mënyrën e lustrimit, gjatë riparimit të elementeve me mjetet përkatëse sipas kërkesës;
- Të listojë llojet dhe mënyrat e riparimeve të elementeve të dëmtuar të tapicerisë;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e zëvendësimit të aksesorëve të dëmtuar.

### **Procese përfundimtare**

- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë sipas kartës teknologjike;

- Të dallojë llojet e materialeve dhe mjetet e nevojshme për ambalazhimin, etiketimin dhe paketimin e elementeve;
- Të shpjegojë mënyrat e ambalazhimit dhe etiketimit të materialit të punuar;
- Të shpjegojë mënyrat e paketimit të materialit;
- Të shpjegojë rëndësinë e magazinimit të materialeve të punuara;
- Të shpjegojë rëndësinë e transportit të elementeve të prodhuar sipas standardeve;
- Të shpjegojë mënyrat e montimit përfundimtar sipas radhës.

### **Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit**

- Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik në makinat bazë të përpunimit të drurit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat frezë kopjuese, me zinxhirë, makinat e thithëzimit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në tornot universale e kopjuese;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e shpimit trapano;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e zumparimit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e mprehjes;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e shkurtimit në saktësi dhe formatizimit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë përdorimit të pajisjeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit në repartin e montimit të objekteve prej druri gjatë përdorimit të pajisjeve dhe linjave zinxhir;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë proceseve të punës në pajisjet dhe makineritë për përkuljen e drurit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë proceseve të punës me pajisjet për lustrim, me sprucim, të makinave të derdhjes të llakut dhe tharjes të tij;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit me pajisjet, makinat e imitimit dhe patinimit të drurit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të prerjes dhe qepjes, së materialit të veshjes, me veglat me pajisjet dhe makinat që përdoren për këtë proces;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të përgatitjes së materialeve për mbushje, për krijimin e bazës së tapicerisë me susta dhe sfungjer, qepjes së dyshekut e të veshjes, me pajisjet dhe makinat përkatëse;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në sheshe, reparte, magazina etj.;
- Të listojë shkaqet e zjarreve dhe duke përshkruar rregullat e mbrojtjes sipas rastit;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të pajisjeve kundra zjarrit sipas kushteve;
- Të shpjegojë mënyrën e zbatimit të higjienës personale në punë;
- Të shpjegojë mënyrën për dhënien e ndihmës e parë në raste aksidenti në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të kushteve teknike të repartit të lyerjes për ruajtjen e shëndetit punonjësve dhe të mjedisit.



- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të bojërave dhe llakut;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të lëndëve ngjithëse
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurisë së shëndetit të punonjësve gjatë përdorimit të bojërave dhe llakut;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
- Të shpjegojë mënyrën e ndarjes dhe depozitimit të mbetjeve gjatë punës, në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

### **Sipërmarrje dhe edukimi i karrierës**

- Të përshkruajë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj dhe lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore;
- Të përshkruajë ndikimin e sipërmarrjes në biznes dhe funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajë rolin e bankave dhe shërbimet që ato ofrojnë;
- Të listojë llojet e dokumentacioneve;
- Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së mobilitetit lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjeve të materialeve dhe të grafikut të kohës së punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e regjistrimit i të dhënave për faturat dhe mënyra e përgatitjes së një oferte;
- Të listojë llojet e raportimeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të tregut për çmimet dhe cilësinë e materialeve bazuar në standardet e caktuara;
- Të listojë elementet e llogaritjes së kostos së materialeve dhe çmimit të një shërbimi;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/ shërbimin që do të kryejë;
- Të listojë elementet e llogaritjes përfundimtare për punimet/shërbimet e ofruara;
- Të listojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve dhe mënyra e përgatitjes;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut për aktivitetin e vet
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.

### **Komunikon në mënyrë etike dhe profesionale**

- Të shpjegojë metodat e informacionit për problemet dhe të rehat e ditës;
- Të shpjegojë rëndësinë e mënyrës së komunikimit dhe metodat e tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e parimeve të punës në grup;
- Të listojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përshkruajë kodin e etikës;
- Të listojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;

- Të listojë bashkëpunëtorët dhe roli i tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të përshkruajë përdorimin e terminologjisë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

## **Rezultatet e të nxënit në:**

# **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Mobileri dhe tapiceri ” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë aftësitë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të analizojë plotësimin e kërkesës së klientit sipas mundësive ekzistuese.
- Të skicojë skemën e objektit prej druri, sipas kërkesës së klientit.
- Të kryejë vizatime përmbledhëse të objektit sipas kërkesës së klientit;
- Të kryejë vizatime të detaleve sipas radhës, me numrin e nevojshëm të pamjeve, gjatë zbërthimit të objektit të kërkuar;
- Të planifikojë lëndën e parë drunore dhe prodhime gjysmë të gatshme prej druri sipas specifikimeve teknike të skicës.
- Të planifikojë materiale ndihmëse të nevojshme sipas modelit në skicë.
- Të planifikojë proceset e punës sipas kartës teknologjike.
- Të planifikojë burimet njerëzore të specializuara sipas proceseve të punës.
- Të planifikojë burimet financiare të nevojshme sipas skicës.
- Të planifikojë afatin kohor të realizimit të objektit sipas kërkesës dhe kushteve të punës.
- Të sigurojë lëndën e parë si lëndë drusore apo prodhime gjysmë të gatshme sipas standardit.
- Të sigurojë materialet ndihmëse sipas projektit të vizatuar.
- Të sigurojë mjetet dhe makinat sipas proceseve të punës në kartën teknologjike.

### **Përgatitja e vendit të punës**

- Të kryejë matjet sipas radhës në vendin ku do të montohet objekti;
- Të skicojë objektin sipas matjeve dhe modelit;
- Të konsultohet me klientin për saktësinë e skicës, sipas modelit të kërkuar;
- Të kryejë vizatime përmbledhëse të objektit përkatës prej druri;
- Të kryejë vizatime të detaleve sipas radhës, me numrin e nevojshëm të pamjeve, gjatë zbërthimit të objektit përkatës prej druri;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve sipas veçorive dhe përdorimit të tyre;
- Të përcaktojë llojet dhe proceseve të punës që kryhen sipas kartës teknologjike;
- Të përzgjedhë llojet e veglave dhe pajisjeve të mekanizuara të dorës sipas proceseve që kryen;
- Të përzgjedhë llojet e makinerive sipas proceseve që kryejnë;
- Të organizojë vendin e punës, në mënyrë ergonomike;
- Të sistemojë materialet në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit me mjetet përkatëse të transportit;

- Të përzgjedhë instrumentet përkatëse sipas makinave;
- Të montojë me saktësi instrumentin në makinën përkatëse sipas manualit;
- Të kontrollojë gatishmërinë e instrumentit për punë sipas procesit dhe cilësisë në skicë;
- Të kontrollojë funksionimin e makinerive për të evidentuar defekte mekanike dhe elektrike sipas manualit;
- Të kryejë regjistrimin e makinerive sipas proceseve teknologjike;
- Të kryejë sistemimin e materialeve të përpunuara sipas proceseve;
- Të pastrojë vendin e punës me mjetet përkatëse të pastrimit.

### **Mjetet, veglat dhe pajisjet e punës**

- Të përzgjedhë mjetet, veglat dhe pajisjet e duhura sipas procesit të punës;
- Të përdorë mjetet e pajisjet e duhura për matje dhe shënjime;
- Të përdorë makinat për mprehjen e instrumenteve prerës;
- Të përdorë instrumentet e sharrimit në vartësi të llojeve të punimit;
- Të përdorë instrumentet e drejtimit në vartësi të llojeve të punimit;
- Të përdorë instrumentet e frezimit në vartësi të llojeve të punimit;
- Të përdorë mjetet e pajisjet e nevojshme për ngjitjen e elementeve;
- Të përdorë mjetet e punës në linjat e lustrimit me sprucim dhe me zhytje;
- Të përdorë mjetet e punës në linjat e përpunimit të shtresës të llakut dhe tharjes;
- Të përdorë mjetet e punës gjatë proceseve të imitimit të drurit;
- Të përdorë mjetet për kontroll të prodhimit të objekteve prej druri;
- Të përdorë mjetet e punës për montimin e mobilieve në mënyra të ndryshme;
- Të përdorë aksesoret e nevojshëm për montimin e mobilieve dhe objekteve prej druri;
- Të përzgjedhë mjetet e duhura të punës për punime tapicerie;
- Të përdorë mjetet e punës për tapicerinë;
- Të përdorë mjetet e punës për procesin e përgatitjes të materialeve për mbushje;
- Të përgatisë mjetet e punës për sektorin e procesit të krijimit të bazës të tapicerisë, me susta dhe sfungjer;
- Të përdorë mjetet e punës për procesin e qepjes së dyshekut të materialit mbushës e të veshjes;
- Të përdorë mjetet e punës për procesin e qepjeve dhe vendosjen e elementeve dekorativë në objektet e tapicerisë;

### **Punime me vegla dore dhe mjete të mekanizuara të dorës**

- Të lexojë manualët dhe skemat e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve sipas proceseve të punës;
- Të kryejë matjet dhe shënjimet mbi materialin drunor, me mjetet përkatëse sipas skicës;
- Të shkurtojë me sharrat (shirit, disk) e dorës dhe të mekanizuara të dorës, sipas shënjimit në material;
- Të kryejë zdrukthtimin e drurit me zdrukthe dore dhe zdrukthe të mekanizuara të dorës, sipas trashësisë së detalit;
- Të kryejë punime shpimi sipas modelit në skicë;
- Të kryejë punime profilimi sipas modelit në skicë;
- Të kryejë punime axhustimi dhe relevimi sipas modelit në skicë;
- Të zumparojë materialin drunor me pajisje dore dhe mjete të mekanizuara të zumparimit, sipas kërkesës;
- Të pastrojë me kujdes detalet e punuara mbas çdo procesi pune, sipas shkallës së pastërtisë;

- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të kryera sipas specifikimeve teknike të skicës;

### **Punime në Makineri**

- Të lexojë manualët dhe skemat kinematike të makinave dhe linjave të mekanizuara sipas proceseve të punës;
- Të kryejë procese të sharrimit të drurit sipas përmasës së caktuar në makinat sharrë shirit, sipas instruksioneve përkatëse;
- Të kryejë procese të shkurtimit me saktësi në makinat sharrë disk, sipas skicës;
- Të kryejë drejtimin në faqe dhe brinjë të detalit në makinat plan, sipas kartës teknologjike;
- Të kryejë procesin e nxjerrjes në trashësi të detaleve, në makinat grosecë, sipas skicës;
- Të realizojë punime në makinën frezë, kopjuese, me zinxhirë duke pasur parasysh parimin e punimit me kopjim;
- Të realizojë punime me makinat e thithëzimit;
- Të kryejë punime në makinën torno universale;
- Të kryejë punime në tornon kopjuese duke pasur parasysh parimin e punimit me kopjim;
- Të realizojë punime të ndryshme në makinat e shpimit të drurit me shumë punto;
- Të realizojë punime të ndryshme në makinat e zumparimit të drurit;
- Të realizojë punime në makinat e formatizimit të pllakave me bazë druri;
- Të realizojë punime në makinën e kalibrimit të pllakave të ndryshme me bazë druri
- Të kryejë punime me makina montimi;
- Të kryejë bordimin në brinjë me tenie, rimeso, plastikë të pllakave me bazë druri, me bordatriçe sipas kërkesës;
- Të përdorë makineritë për përkulje të drurit me apo pa trajtim paraprak të tij;
- Të përdorë makinat për lyerjen e drurit me lëndë ngjitëse;
- Të përdorë pajisjet dhe makinat për lustrimin e drurit me sprucim etj.;
- Të kryejë punime me makinat për tapicerinë e avancuar.
- Të kontrollojë punimet e kryera me makina të punimeve të drurit;

### **Punime finisimi**

- Të përgatisë materialin patinues për drurin, sipas recetës;
- Të kryejë punime patinimi në dru, me makina;
- Të realizojë imitime të thjeshta të drurit;
- Të përdorë pajisje dhe makina të imitimit të drurit;
- Të kryejë procese stukimi mbi sipërfaqen e drurit me stukon përkatëse sipas recetës;
- Të kryejë punime zumparimi sipas specifikimeve teknike;
- Të aplikojë lëndën ngjitëse, sipas normativës, në detale me mjetet dhe makinat përkatëse;
- Të kryejë procese ngjitje të elementeve;
- Të kryejë procese lyerje dhe lustrimi me mjetet dhe makinat e thjeshta, sipas kërkesës;
- Të kryejë procese tharje të shtresave të lustrës me mënyra të ndryshme duke respektuar parametrat teknologjikë;
- Të realizojë aplikime të thjeshta të lëndëve kimike në dru;
- Të vendosë aksesorët e nevojshëm me mjetet përkatëse sipas kërkesës.

### **Punime montimi**

- Të transportojë materialin e punuar në sektorin e montimit në mënyrë të sigurt;
- Të kryejë kontrolle të saktësisë së punimeve sipas përmasave në skicë, me mjetet përkatëse të kontrollit;
- Të kryejë ndarjen e elementeve sipas përmasave në skicë;
- Të përcaktojë radhën e montimit sipas modelit të caktuar;
- Të kryejë montimin paraprak, pa ngjitje të elementeve përbërës të objektit, sipas radhës të caktuar;
- Të kryejë eliminimin e defekteve të konstatuar;
- Të përzgjedhë pajisjet, makinat për montim;
- Të kryejë veshjen e brinjëve me teni, plastikë, rimeso etj. me dorë apo makinë;
- Të përdorë mënyrën e montimit artizanal të mobilieve;
- Të montojë sipas radhës së veprimeve për montim të mobilieve të ndryshme;
- Të përdorë linjat zinxhir për montimin e mobilieve të ndryshme;
- Të realizojë montime të mobileve të përkulura;

### **Punime tapicerie**

- Të skicojë skemat e skeleteve prej druri të objekteve të ndryshme të tapicerisë;
- Të skicojë skemat e tapicerisë së mobilieve me bazë sfungjeri dhe materiale të tjera;
- Të kryejë punime të veçanta gjatë ndërtimit të skeleteve që vishen me tapiceri;
- Të përgatitë tipet e skeleteve sipas materialit përkatës, të ndërtimit të tyre;
- Të kryejë punime për ndërtimin dhe montimin e skeleteve të objekteve të tapicuara me bazë druri;
- Të kryejë punime të prerjes dhe qepjes të materialit për veshjen e mobilieve të tapicerisë;
- Të kryejë punime për përgatitjen e materialeve për mbushje, për objekte të ndryshme tapicerie;
- Të kryejë punime për krijimin e bazës të tapicerisë me susta dhe sfungjer, për objekte të ndryshme tapicerie;
- Të kryejë punime për qepjen e dyshekut, të materialit mbushës e të veshjes për objekte të ndryshme tapicerie;
- Të kryejë punime të qepjeve dhe vendosjes së elementeve dekorativë për objekte të ndryshme tapicerie.

### **Mirëmbajtje të pajisjeve dhe makinerive.**

- Të kryejë operacione të mirëmbajtjes të instrumenteve të makinave të ndryshme që përdoren në prodhimin e objekteve prej druri si sharrë, plan, grosecë, frezë etj.;
- Të vendosë dhe regjistrojë instrumentet prerës në makineri;
- Të kryejë procese të mprehjes së instrumenteve me makinën përkatëse;
- Të kryejë riparime të thjeshta në makinat e ndryshme që përdoren në prodhimin e objekteve prej druri, mobilieve dhe objekte tapicerie;

### **Riparime dhe restaurime për objekte druri**

- Të identifikojë defektet në elementet e punuar sipas llojit të tij.
- Të përcaktojë saktë mënyrat e riparimit të defekteve tek elementët e dëmtuar sipas kartës teknologjike.

- Të përcaktojë hapat e mirëmbajtës dhe restaurimit të objekteve të përdorura, prej druri dhe me material gjysmë të gatshme;
- Të kryejë procese të disinfektimit, me antiseptikë të objekteve të përdorura prej druri
- Të kryejë procese pastrimi të objekteve prej druri me solucione dhe mjete përkatëse;
- Të kryejë procese të cenoblimit të elementit të dëmtuar me mjetet përkatëse sipas standardit.
- Të kryejë veshje me teni, rimeso, plastikë etj. gjatë riparimit;
- Të kryejë procesin e patinimit dhe lustrimit, të plotë apo të pjesshme gjatë restaurimit;
- Të kryejë procese ngjitjeje gjatë riparimit të elementeve me lëndë ngjitëse, të përgatitura sipas recetës.
- Të kryejë procese pune të riparimeve në tapiceri;
- Të kryejë procese pune të ndërrimit të aksesorëve të dëmtuar.

### **Procese përfundimtare**

- Të kontrollojë cilësinë, sipas kartës teknologjike me mjetet e kontrollit;
- Të përdori materialet dhe mjetet e nevojshme për ambalazhimin, etiketimin dhe paketimin e elementeve;
- Të kryejë procese të ambalazhimit dhe etiketimit me materialet dhe mjetet përkatëse sipas standardeve;
- Të kryejë procese të paketimit të materialit, sipas standardeve;
- Të kryejë procese të magazinimit të elementëve të prodhuar, sipas standardit të magazinimit;

### **Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit**

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në makinat bazë të përpunimit të drurit, si sharrat shirit, sharra rrethore disk, plan, grosecë;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat frezë kopjuese, me zinxhirë, makinat e thithëzimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në tornot universale e kopjuese;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat zumparuese;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e mprehjes;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e shkurtimit në saktësi dhe formatizimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë përdorimit të pajisjeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit në repartin e montimit të objekteve prej druri gjatë përdorimit të pajisjeve dhe linjave zinxhir;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë proceseve të punës në pajisjet dhe makineritë për përkuljen e drurit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë proceseve të punës me pajisjet për lustrim, me sprucim, të makinave të derdhjes të llakut dhe tharjes të tij;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit me pajisjet, makinat e imitimit dhe patinimit të drurit;

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të prerjes dhe qepjes së materialit të veshjes, me veglat me pajisjet dhe makinat që përdoren për këtë proces;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të përgatitjes së materialeve për mbushje, për krijimin e bazës së tapicerisë me susta dhe sfungjer, qepjes së dyshekut e të veshjes, me pajisjet dhe makinat përkatëse;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimit në makinat e qepjeve dhe vendosjes së elementeve dekorative;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në sheshe, reparte, magazina etj.;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes sipas rastit dhe shkaqeve;
- Të përdorë pajisjet kundra zjarrit sipas kushteve teknike përkatëse;
- Të sigurojë kushtet higjieno/sanitare në punë;
- Të japë ndihmën e parë në raste aksidenti në punë;
- Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve përgatitore për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit;
- Të respektojë kushtet teknike të repartit të lyerjes për ruajtjen lidhur me sigurimin e shëndetit punonjësve dhe të mjedisit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të bojërave dhe llakut;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të lëndëve ngjitëse;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë së shëndetit të punonjësve gjatë përdorimit të bojërave dhe llakut;
- Të përdorë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
- Të zbatojë rregullat e ndarjes dhe depozitimit të mbetjeve gjatë punës, në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

### **Sipërmarrje dhe edukimi i karrierës**

- Të hartojë një plan të thjeshtë për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse;
- Të identifikojë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të zbatojë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit;
- Të zbatojë legjislacionin e punës dhe elementet përbërëse të tij;
- Të plotësojë një dokumentacion të thjeshtë teknik;
- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.
- Të plotësojë siç duhet planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat dhe llojit të punimeve;
- Të arkivojë dokumentacionin e punës së kryer, konsumimin e materialeve dhe urdhrat e punës në mënyrë të saktë;
- Të regjistrojë saktë të dhënat për faturat dhe ofertat e lëshuara klientëve;
- Të marrë pjesë rregullisht në përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të kontrollojë rregullisht tregun lidhur me çmimet dhe cilësinë e materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
- Të kryejë llogaritje të sakta të kostos së materialeve dhe shërbimeve të kryera në bazë të projektit të dhënë;

- Të përgatisë siç duhet oferta për punimet/ shërbimin që do të kryejë afërsisht me çmimet aktuale të tregut;
- Të kryejë blerje të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve sipas nevojave dhe standardit të ndërtimit;
- Të llogarisë saktë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;

### **Komunikimi etik dhe profesional**

- Të marrë informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të zbatojë drejt dhe saktë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë parimet e punës në grup në mënyrë korrekte;
- Të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Të japë dhe marrë udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë në komunikim;
- Të zbatojë teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të shpejtë me të tjerët duke u përshtatur me to;
- Të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur komunikimin e duhur;
- Të përdorë terminologji profesionale gjatë veprimtarisë së vet;
- Të veprojë në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

### **Individi duhet të jetë i aftë:**

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiviente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.